

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6909
E mërkurë, 31 maj 2023
Çmimi 0.40 €

Zëvendëssekretari Fries
vlerëson lart Kosovën për
dënimin publik dhe
sanksionet kundër Rusisë

FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

"SANKSIONET" E PARA PËR KOSOVËN: ANULIMI I "DEFENDER EUROPE 2023", MOSLOBIMI
PËR NJOHJE DHE MOSVULLNET PËR TAKIME SHBA - KOSOVË

FAQE 4

QEVERIA KURTI ACARON RAPORTET E KOSOVËS ME SHBA-në



Për shkak të veprimeve të njëanshme në veri të Kosovës, qeveria Kurti ka acaruar seriozisht raportet me ShBA-në. Ambasadori i ShBA-së, Jeffrey Hovenier, ka thënë se për shkak të

situatës në veri dhe refuzimit të këshillave amerikane, është anuluar pjesëmarrja e Kosovës në stërvitjet "Defender Europe 2023". Ai ka thënë se ShBA-ja nuk ka disponim që të

lobojë për Kosovën të shtetet mosnjohëse. Po ashtu, ai ka thënë se do të "çuditësia nëse në këtë situatë zyrtarët e Kosovës do të kishin vizita në ShBA"

TENSIONET NË VERI LËVIZIN NATO-n: MERR VENDIM TË DËRGOJË FORCA SHITESË NË KOSOVË

Aleanca ushtarake e NATO-s ka njoftuar të martën se si përgjigje ndaj trazirave të fundit dhe plagosjes së 30 pjesëtarëve të KFOR-it në Kosovë, do të dërgojë trupa shtesë nga Forcat Rezervë Operacionale për Ballkanin Perëndimor. Edhe të martën forcat paqeruajtëse janë vendosur para ndërtesave të komunave veriore të Kosovës, para të cilave janë mbledhur sërish grupe serbësh për ta kundërshtuar hyrjen e kryetarëve shqiptarë. Shefi i diplomacisë i Bashkimit Evropian, Josep Borrell, ka bërë me dije se është duke bërë përpjekje të organizojë një takim urgjent të nivelit të lartë në mes të kryeministrit Albin Kurti dhe presidentit Aleksandër Vuçiq



AKTUALE



"ISHTE 14 VJEÇ, E KEOTRAJTUAN,
E KËRCËNUAN DHE NUK TREGOI
VENDNDODHJEN E USHTARËVE TË
UÇK-së" F. 9

NAGAVCI I FTON KOMUNAT PËR
SHËNIMIN E HAPËSIRAVE PËR
NDËRTIMIN E ÇERDHEVE TË REJA

F. 7

VAZHDOJNË LUFTIMET NË SUDAN
PAVARËSISHT PREJ ARMËPUSHIMIT
TË RI

F. 2

AGK-ja RAPORTON PËR DISA SULME
NDAJ GAZETARËVE NË VERI

F. 5



EKONOMI

PAGA MESATARE 521 EURO NË
KOSOVË, VETËM 37 EURO RRIJTE
NË VITIN 2022

F. 8

10 MIJË PUNËTORË TË
REGJISTRUAR NË PLATFORMËN
"SUPER PUNA"

F. 8

SPORT

KOK-u ANKOHET NË KOMITETIN
OLIMPIK NDËRKOMBËTAR PËR
MESAZHIN E PROVOKATORIT GJOKOVIC

F. 10

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Nuk na ka faj Perëndimi, por drejtimi



Muhamet MAVRAJ

Këto abuzimet serike me uniformat tona të mrekullueshme dhe me simbolet e shtetit në veri; kurthimet e tërheqjet kokulur e të sharë; me

kostot tona gjithnjë në favor të palës serbe janë bërë sport normal. Një argëtim ruso-serb.

Që ta dini, as në fillim, pra më 1997, nuk jemi nisur pa amerikanët. Natyrisht, të bindurit ishte proces, hap pas hapi, qysh nga ardhja këtu, më 1996. Shumë takime e diskutime, maturi dhe këshillime. Nuk na lanë vetëm kurrë. As pastaj, as gjatë luftës, as pas luftës, në detajet më të imëta projektuan ditën e pavarësisë së Kosovës, në cikërrimat më të pabesueshme, 2008. Ata ishin shtylla kurrizore në betejën juridike në Hagë, 2010. Me ta

kemi arritur 117 njohje ndërkombëtare dhe atje kemi mbetur moti duke u shkryer në sqotë. Sa vite humbëm kot me gjepura e propagandë linçuese bash me metodat e shtrydhura serbiane.

Mandati i mikut Biden, duke u zvarritur nëpër copëza të problemeve shqiptare e serbe në këto vitet e fundit, po zhduket bosh për Kosovën. Zvarritja dhe përplasja ishte strategjia e kahershme ruso-serbe.

Sikurse e kemi thënë këtu, fundja, më shumë rëndësi ka drejtimi sesa shpejtësia. Herët a vonë,

pavarësisht ndonjë lakeze që shfaqet majtas-djathtas gjatë rrugës, e kriposur me propagandë "patriotike", duke ecur në drejtim të gabuar, do të mbërrimë pa dyshim në cakun e gabuar.

Prandaj ramë te pika famëkeqe 7 e Brukselo-Ohrit. Dhe, mund të na duket lule në krahasim me pasojat e radhës në këtë drejtim të gabuar, por të qëllimshëm, programik.

Të shpëtojmë çfarë mund të shpëtojmë nga garancitë tona nën mburojën amerikane. Thjesht, amerikane. Pa të nuk ka Evropë të sigurt e lërë me Kosovë të sigurt.

Duhet ta mendojmë, flasim dhe

veprojmë pa emocione, me tru. Nuk jemi qendra e botës.

Perëndimi, në fakt, është në luftë kundër ruso-serbëve fashistë e zjarrvënës të cilët po fërkojnë duart mbi ngutjet tona serike në veri. Prej 7-8 ditësh lufta është bartur në Rusi e mbrëmë mbi qytetin e Moskës. Nuk është detyra jonë ta shpëtojmë as Serbinë nga përplasjet e brendshme duke i dhënë kaq shumë raste për ta mbajtur zgjuar çetnikizmin e saj të verbër. Ndjekim interesin tonë që është në orbitën e qytetërimit perëndimor, shkurt, amerikan.

Zëvendëssekretari Fries vlerëson lart Kosovën për dënimin publik dhe sanksionet kundër Ruisë

"Epoka e re"

PRISHTINË, 30 MAJ - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të martën në takim zëvendëssekretarin e Përgjithshëm për Paqe, Siguri dhe Mbrojtje në Shërbimin Evropian të Veprimit të Jashtëm (EEAS), Charles Fries, i shoqëruar nga shefi i Zyrës së BE-së në Kosovë, Tomas Szunyog dhe shefi i EULEX-it, Lars-Gunnar Wigemark. Në takim u diskutua për përparimin e Kosovës drejt Bashkimit Evropian, me ç'rast presidentja Osmani ritheksoi përkushtimin e Republikës së Kosovës për integrimin euroatlantik.

Në veçanti, presidentja e ka informuar Friesin për përparimin e bërë në fushën e sundimit të ligjit, që përfshin edhe luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit si dhe për reformat demokratike dhe për përafrimin e plotë të politikës së jashtme dhe të sigurisë me atë të BE-së.

Më tutje, zëvendëssekretari Fries vlerësoi lart bashkërendimin e



Kosovës për dënimin publik dhe sanksionet kundër Ruisë si dhe përkrahjen e vazhdueshme ndaj Ukrainës.

Presidentja Osmani dhe zëvendëssekretari Fries diskutuan edhe për zhvillimet e fundit në veri të Republikës së Kosovës. Presidentja ka përsëritur dënimin e fuqishëm për sulmet e strukturave ilegale serbe të shndërruara në banda kriminale kundër policisë së Kosovës, KFOR-it dhe gazetarëve.

Presidentja Osmani ka potencuar se këto banda kriminale, të

mbështetura nga Vuçiqi, kanë për qëllim destabilizimin e Kosovës dhe të gjithë rajonit, prandaj veprimet e tyre të rrezikshme duhet të dënohen nga të gjithë. Më tutje, presidentja Osmani vuri theksin në nevojën e koordinimit me partnerët ndërkombëtarë, si hap i domosdoshëm në mënyrë që të sigurohet paqe dhe stabilitet afatgjatë në vend e rajon, ndërsa përmendi rëndësinë e sundimit të ligjit dhe përballjen me drejtësinë për bandat kriminale dhe veprimet e tyre të kundërligjshme.

Haxhiu dhe Fries diskutojnë për vetingun

Ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, është takuar të martën me zëvendëssekretarin e Përgjithshëm për Paqe, Siguri dhe Mbrojtje në Shërbimin Evropian të Veprimit të Jashtëm (EEAS), Charles Fries, shefin e zyrës së BE-së në Kosovë, Tomas Szunyog, shefin e EULEX-it në Kosovë, Lars-Gunnar Wigemark dhe përfaqësues të tjerë.

Gjatë këtij takimi ministrja Haxhiu foli për prioritetet e Ministrisë së Drejtësisë, me theks të veçantë reformën në drejtësi, çështjen e vetingut dhe ndryshimet e nevojshme ligjore si dhe adresimin e luftës kundër dhunës në familje dhe trajtimin e krimeve të luftës.

Ministrja Haxhiu vlerësoi lart bashkëpunimin e Ministrisë së Drejtësisë me mekanizmat e BE-së dhe misionin e EULEX-it në fushën e sundimit të ligjit.

Në këtë takim është diskutuar edhe për situatën e krijuar së fundmi në veri të Mitrovicës pas zgjedhjeve lokale të 23 prillit ku u zgjodhën katër kryetarë të rinj shqiptarë.



NATO-ja synon t'i afrohet një plani për anëtarësimin e Ukrainës

KIEV, 30 MAJ - Ministrat e jashtëm të NATO-s do të tentojnë t'i përafrojnë qëndrimet lidhur me kërkesën për anëtarësim të Ukrainës në një takim në Oslo të Norvegjisë këtë javë.

Aleatët deri më tani nuk kanë arritur të pajtohen për kërkesat që Kievit t'i jepet një udhërrëfyes drejt anëtarësimit në NATO në samitin që do të zhvillohet në korrik.

NATO nuk e ka pranuar kërkesën e Ukrainës për anëtarësim të shpejtë pasi qeveritë e vendeve perëndimore, si ShBA-ja dhe Gjermania, po veprojnë me kujdes në atë mënyrë që të mos e çojnë aleancën më afër hyrjes në



një luftë aktive me Rusinë. Megjithatë, Kievit dhe disa nga aleatët e tij më të afërt në Evropën Lindore kanë bërë

presion që NATO të paktën të ndërmarrë hapa konkretë për ta sjellë Ukrainën më afër anëtarësimit në samitin e

aleancës që do të mbahet në Vilnius, Lituani, më 11-12 korrik.

"Do të ishte shumë e trishtueshme nëse dikush e lexon rezultatin e samitit të Vilniusit si një fitore të Ruisë në pengimin e Ukrainës për t'u bashkuar me NATO-n një ditë", tha kryeministrja e Lituaniës, Ingrida Simonyte.

Javën e kaluar sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, e bëri të qartë se Ukraina nuk do të mund të anëtarësohet në NATO përderisa lufta kundër Ruisë vazhdon. "Anëtarësimi në mes të një lufte nuk është në agjendë", tha ai. "Çështja është se çfarë do të

ndodhë kur të përfundojë lufta". NATO ra dakord në samitin e vitit 2008 në Bukuresht që Ukraina do të anëtarësohet në të ardhmen. Megjithatë, që nga atëherë, udhëheqësit e NATO-s nuk kanë ndërmarrë ndonjë hap për ta realizuar një gjë të tillë si, për shembull, duke i dhënë Kievit një plan veprimi për anëtarësim që do ta përcaktonte një plan kohor për bashkimin e vendit me NATO-n. Në margjinat e takimit të tyre në Oslo më 31 maj dhe 1 qershor, ministrat e Jashtëm pritët të flasin edhe për kërkimin për një shef të ri të NATO-s, pasi që Stoltenbergu largohet nga kjo pozitë në shtator.

“SANKSIONET” E PARA PËR KOSOVËN: ANULIMI I “DEFENDER EUROPE 2023”,
MOSLOBIMI PËR NJOHJE DHE MOSVULLNET PËR TAKIME SHBA - KOSOVË

Qeveria Kurti acaruar raportet e Kosovës me ShBA-në

Për shkak të veprimeve të njëanshme në veri të Kosovës, qeveria Kurti ka acaruar seriozisht raportet me ShBA-në. Ambasadori i ShBA-së, Jeffrey Hovenier, ka thënë se për shkak të situatës në veri dhe refuzimit të këshillave amerikane, është anuluar pjesëmarrja e Kosovës në stërvitjet “Defender Europe 2023”. Ai ka thënë se ShBA-ja nuk ka disponim që të llojë për Kosovën te shtetet mosnjohëse. Po ashtu, ai ka thënë se do të “çuditësia nëse në këtë situatë zyrtarët e Kosovës do të kishin vizita në ShBA”

EPOKA
ERE

Lirim GEÇI

PRISHTINË, 30 MAJ - Moskoordinimi i Qeverisë së Kosovës për veprimet në veri ka acaruar raportet me Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA). Për këto reparte ka folur të martën ambasadori i ShBA-së në Prishtinë, Jeffrey Hovenier. Në një takim me disa gazetarë në Prishtinë, ai ka thënë se Qeveria e Kosovës nuk është koordinuar me Shtetet e Bashkuara për veprimet e ndërmarra të premtën në veri. Atë ditë kryetarët e rinj shqiptarë të komunave me shumicë serbe në veri të Kosovës - Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan - kanë hyrë në ndërtesat komunale me ndihmën e Policisë së Kosovës përkundër rezistencës së banorëve lokalë serbë. “Kur kemi marrë vesh, kemi reaguar ashpër kundër. Vendimi ka pasur ndikim negativ në reputacionin e Kosovës dhe i ka kthyer mbrapsht përpjekjet drejt normalizimit të marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë”, ka thënë Hovenier.

Ai e ka cituar sekretarin amerikan të Shtetit, Antony Blinken, i cili ka thënë se këto veprime do të ndikojnë në marrëdhëniet ShBA - Kosovë. “Jemi shumë të shqetësuar për situatën në veri dhe besojmë se kjo krizë nuk ishte e nevojshme. Veprimet e ndërmarra të premtën për të marrë qasje në ndërtimet publike nuk ishin të koordinuara me ShBA-në. Kur morëm vesh,

fuqishëm thamë jo, sepse i parashikuam pasojat që po i shohim tash. Besojmë që kishte impakt negativ për imazhin e Kosovës dhe i dëmtoi përpjekjet për normalizim të raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Dhe siç e kemi thënë (sekretari Blinken), kryeministri po i afekton raportet në mes të Kosovës dhe ShBA-së”, ka thënë ai.

Në kontekst të këtyre raporteve, Hovenieri ka thënë se anulimi i pjesëmarrjes së Kosovës në stërvitjet “Defender Europe 2023” është pasoja e parë për Qeverinë e Kosovës në këtë drejtim.

“Sot nuk ka pasur aktivitet për 'Defender Europe '23' dhe nuk do të ketë. Për Kosovën, ato stërvitje kanë marrë fund. Ne i kemi kërkuar (kryeministrit të Kosovës, Albin) Kurti që të marrë hapa drejt uljes së tensioneve në veri. Ai nuk u është përgjigjur këtyre kërkesave. Ne jemi duke analizuar se cilat do të jenë veprimet tona të tjera”, ka thënë ai.

Në këtë takim Hovenieri ka folur edhe për disponimin aktual të ShBA-së ndaj Kosovës. Ai ka thënë se ShBA-ja nuk ka disponim që të llojë për Kosovën te shtetet mosnjohëse. “Më duhet të them se në këtë koment ShBA-ja nuk ka shumë entuziazëm për të reaguar ndaj disa interesave të Kosovës, siç është angazhimi me vendet mosnjohëse, apo puna aktive për ta avancuar Kosovën në rrugën euroatlantike”, ka thënë ai, duke shtuar se ndien keqardhje që situata ka ardhur deri këtu.

“Ndiejmë shumë keqardhje që



situata ka ardhur deri këtu, mirëpo më duhet të jem i sinqertë, kështu është situata. Shpresojmë se kryeministri Kurti do ta marrë këshillën tonë dhe do të marrë menjëherë hapa drejt uljes së tensioneve në veri”, ka thënë ambasadori amerikan. Sipas tij, ulja e tensioneve e kthen më pas vëmendjen te zbatimi i plotë i Marrëveshjes për normalizim të marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Kosova dhe Serbia janë pajtuar për këtë marrëveshje në shkurt të këtij viti në Bruksel, ndërsa për aneksin e zbatimit në mars në Ohër. Më tutje, ambasadori amerikan ka thënë se Shtetet e Bashkuara i kanë

dy kërkesa për Qeverinë e Kosovës: të mos insistojë që kryetarët të punojnë nga ndërtesat komunale dhe që t'i tërheqë zyrtarët policorë nga tri ndërtesat komunale në veri. “Ne nuk e kuptojmë pse nuk mund të shfrytëzohen lokacione alternative, apo ndërtesa të tjera publike, për kryerje të funksioneve të tyre”, ka thënë Hovenieri, duke përmendur shembullin që kryetarët e komunave në veri janë betuar në lokacione alternative. “Ne besojmë se prania e Policisë së Kosovës në ndërtesa, e cila ka hyrë me forcë, është tejet sfiduese, prandaj i kemi kërkuar qeverisë ta tërheqë policinë nga këto tri ndërtesa komunale”, ka thënë ai.

Sipas Hovenierit, këto veprime do të ndihmonin në uljen e tensioneve.

I pyetur nëse do të kishte pasoja edhe sa iu përket vizitave që mund t'i bënin zyrtarët e qeverisë Kurti në ShBA, ambasadori Hovenier ka thënë se “do të ishte i çuditur nëse do të kishin ndonjë takim me zyrtarët amerikanë”. “Do të çuditësia nëse në këtë situatë zyrtarët e Kosovës do të kishin ndonjë vizitë bilaterale të nivelit të lartë me ndonjë zyrtar amerikan apo anasjelltas”, ka thënë ai. Duke iu referuar këtyre deklaratave, Kosova dhe ShBA-ja asnjëherë nuk i kanë pasur raportet në këtë nivel kaq të ulët.

UKZ-ja dhe komuna e Gjilanit diskutojnë për ndërtimin e kompleksit universitar

GJILAN, 30 MAJ - Rektori i Universitetit Publik “Kadri Zeka” në Gjilan, Bajram Kosumi, si dhe kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, me bashkëpunëtorë, kanë vizituar lokacionin i cili është i përshtatshëm për krijimin e hapësirës për ndërtimin e kompleksit universitar. Pas shikimit të vendit në terren, lokacioni më i përshtatshëm i kompleksit të Universitetit Publik “Kadri

Zeka” është propozuar të jetë hapësira që gjendet në pjesën jugore të qytetit të Gjilanit, respektivisht hapësira afër tregut të veturave, në afërsi të dy hyrjeve kryesore në qytet - Prishtinës dhe Ferizajt, që lidh Luginën e Preshevës në anën lindore.

Lokacioni i propozuar nga kryetari Hyseni është parë si mundësi e mirë për ndërtimin e hapësirave të reja të kompleksit. Me këtë rast,

rektori Bajram Kosumi e falënderoi kryetarin Hyseni për angazhimin e tij për gjetjen e hapësirës për kompleksin e universitetit dhe theksoi se ndërtimi i kompleksit të UKZ-së ka për qëllim përmirësimin e kualitetit të studimeve përmes sigurimit të hapësirave adekuate, bashkëkohore universitare për akomodimin e studentëve në një kompleks universitar me hapësirë publike të hapur për të gjithë.





Tensionet në veri lëvizin NATO-n: Merr vendim të dërgojë forca shtesë në Kosovë

Aleanca ushtarake e NATO-s ka njoftuar të martën se si përgjigje ndaj trazirave të fundit dhe plagosjes së 30 pjesëtarëve të KFOR-it në Kosovë, do të dërgojë trupa shtesë nga Forcat Rezervë Operacionale për Ballkanin Perëndimor. Edhe të martën forcat paqeruajtëse janë vendosur para ndërtesave të komunave veriore të Kosovës, para të cilave janë mbledhur sërish grupe serbësh për ta kundërshtuar hyrjen e kryetarëve shqiptarë. Shefi i diplomacisë i Bashkimit Evropian, Josep Borrell, ka bërë me dije se është duke bërë përpjekje të organizojë një takim urgjent të nivelit të lartë në mes të kryeministrit Albin Kurti dhe presidentit Aleksandër Vuçiq

Aleanca ushtarake e NATO-s, si përgjigje ndaj trazirave të fundit dhe plagosjes së 30 pjesëtarëve të KFOR-it në Kosovë, ka njoftuar se do të dërgojë trupa shtesë nga Forcat Rezervë Operacionale për Ballkanin Perëndimor.

Komanda e Forcave të NATO-s në Napoli tha se “po ndjek nga afër situatën në Kosovë dhe do të vazhdojë të bashkërendohet me KFOR-in për t’u siguruar se do t’i kenë të gjitha mundësitë dhe forcat që u nevojiten për të siguruar në mënyrë të paanshme një mjedis të sigurt dhe lirinë e lëvizjes për të gjitha komunitetet”. Përlshjet e së hënës shpërthyen në komunën e Zveçanit, kur grupe serbësh hodhën gurë dhe mjete shpërthyes mbi trupat e NATO-s që përdorën gaz lotsjellës për t’i

shpërndarë protestuesit. Disa makina të Policisë së Kosovës dhe të medieve u dëmtuan dhe mbi to u shkruan simbole nacionaliste serbe. Makinës së një televizioni iu vu flaka.

Borrelli: Kosova duhet t’i pezullojë operacionet policore në veri

Shefi i diplomacisë së Bashkimit Evropian, Josep Borrell, ka thënë se Kosova duhet t’i pezullojë operacionet e policisë rreth ndërtesave komunale në veri të shtetit, si “hap i parë për uljen e tensioneve, ndërsa protestuesit e dhunshëm të ndalen”. “Dua të them se BE-ja e dënon fuqishëm dhunën në veri të Kosovës që e kemi parë ditët e fundit. Aktet e dhunës ndaj qytetarëve, medieve, forcave të rendit dhe KFOR-it janë të papranueshme. Ne si BE qëndrojmë prapa NATO-s dhe KFOR-it për përmbushjen e mandatit në interes të paqes dhe stabilitetit në Kosovë”, ka thënë Borrell të martën.

Ai ka theksuar se në mëngjesin e së martës ka biseduar me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, teksa mbrëmjen e së hënës ka zhvilluar një bisedë edhe me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq, dhe i ka ftuar ta “qetësojnë menjëherë situatën dhe pa kushte”. “Çdo hap tjetër i njëanshëm duhet të shmanget. Si hap i parë pres nga Kosova t’i pezullojë operacionet policore të

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

Prishtinë, 30 maj - Forcat paqeruajtëse të udhëhequra nga NATO-ja kanë qëndruar edhe të martën para ndërtesave të komunave veriore të Kosovës një ditë pas përplasjeve me protestuesit serbë. Grupe serbësh janë mbledhur sërish të martën para ndërtesave të komunave për ta kundërshtuar hyrjen e kryetarëve shqiptarë, por situata aktuale është e qetë.

Policia e Kosovës ka dalë të martën me një komunikatë për situatën në veri, duke i ftuar qytetarët për qetësi dhe të mos bienin pre e thirrjeve për protestë të dhunshme dhe provokime të çfarëdo natyre qofshin ato.

Komandanti i KFOR-it, gjeneralmajor Angelo Michele Ristuccia, ka kërkuar nga Kosova dhe Serbia ta marrin “përgjegjësinë e plotë” për ngjarjet që ndodhën më 29 maj në veri të Kosovës dhe “të mos fshihen pas narrativëve të rremë”. Ristuccia ka kërkuar nga palët ta parandalojnë

“çdo përshkallëzim të mëtejshëm” të situatës.

Përmes një njoftimi për medie, misioni paqeruajtës i NATO-s në Kosovë, KFOR, ka theksuar se gjatë ndërhyrjes në Zveçan të hënën, 30 ushtarë të këtij misioni janë lënduar: 19 nga kontingjenti hungarez dhe 11 nga ai italian. “Ata pësuan lëndime të shumta,

përfshirë thyerje dhe djegie nga pajisjet e improvizuara shpërthyes dhe mjete ndezëse”, thuhet në njoftimin e KFOR-it.

Forcat paqeruajtëse thanë se do t’i ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të krijuar një mjedis të sigurt dhe për ta siguruar lirinë e lëvizjes për të gjitha komunitetet në Kosovë.



lidhura me ndërtesat e komunave në veri të Kosovës dhe protestuesit e dhunshëm të ndalen. Ne do të vazhdojmë të jemi të angazhuar me dy liderët që të ndalen protestat”, ka deklaruar Borrelli. Ai, po ashtu, ka pohuar se blloku evropian pret që Kosova dhe Serbia të angazhohen në dialog dhe ta hapin rrugën për zbatimin e marrëveshjes drejt normalizimit të raporteve. “Po punoj që të organizoj një takim urgjent të nivelit të lartë”, ka thënë Borrelli.

Paçarizi: Situata në veri, për keqardhje

Njohësi i zhvillimeve politike në Kosovë, Rahman Paçarizi, e ka cilësuar për “keqardhje” situatën në veri të Kosovës. Duke i komentuar përleshjet e 29 majit në Zveçan, mes protestuesve serbë dhe pjesëtarëve të NATO-s në Kosovë, KFOR, Paçarizi ka thënë se zyrtarët e Kosovës kanë qenë të përmbajtur në reagime në krahasim me zyrtarët serbë që, sipas tij, “në vazhdimësi kanë hedhur benzinë në zjarr dhe mezi kanë pritur që situata të përshkallëzonte tutje”. “Do me thënë, sjellja e djeshme e Qeverisë së Kosovës ishte e përgjegjshme, mirëpo veprimet paraprake, sidomos moskoordinimi i duhur me Shtetet e Bashkuara, por edhe me vendet e Quint-it, mendoj që janë për keqardhje”, ka thënë Paçarizi për “Radion Evropa e Lirë”. Sipas tij, refuzimi i kryetarëve të komunave veriore nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, për t’u takuar me ambasadorin amerikan në Prishtinë, Jeffrey Hovenier, të hënën, ka qenë vendim i papjekur, duke shtuar se Qeveria e Kosovës, por edhe aktorë të tjerë të ngjarjeve në veri, duhet të jenë në sinkron me aleatët ndërkombëtarë, “...apo së paku mes vete, në mënyrë që të mos kemi situata të tilla kur kryetarët nga një parti shkojnë në vendet e tyre të punës në ndërtesat e komunës, ndërsa ata nga një parti tjetër eventuale nuk shkojnë”, ka deklaruar Paçarizi.

“Duhet bërë përpjekje që të gjendet një zgjidhje, e cila është më pak e keqe. Nuk flitet më për zgjidhje më të mira, por për zgjidhje më pak të këqija”, ka shtuar ai.

Vuçiçi kërkon tërheqjen e kryetarëve shqiptarë nga veriu

Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiçi, ka kërkuar tërheqjen e njësisve speciale të Policisë së Kosovës nga veriu i Kosovës ashtu si edhe të kryetarëve të komunave me kombësi shqiptare. Vuçiçi i bëri komentet në takim me ambasadorët e vendeve të Quint-it: Shteteve të Bashkuara, Mbretërisë së Bashkuar, Francës, Gjermanisë dhe Italisë, njofton kabineti i tij. “Shpresoj se do të mund ta bindni [kryeministrin e Kosovës, Albin] Kurti që t’i tërheqë forcat e tij dhe kryetarët personalë nga veriu”, ka thënë Vuçiçi. Në takim morën pjesë edhe ministri i Mbrojtjes i Serbisë, Millosh Vuçević, dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Serbisë, Millan Mojsilović, raporton Radio-Televizioni i Serbisë. Sipas komunikatës që iu dërgua medieve, Vuçiçi ka theksuar se Serbia do ta vazhdojë komunikimin me përfaqësuesit e misionit të NATO-s në Kosovë, KFOR, me “besimin më të mirë për ta ruajtur paqen dhe stabilitetin”. “Presidenti shprehu keqardhjen e tij për ushtarët e lënduar të KFOR-it, por theksoi se një numër shumë më i madh i serbëve u plagosën, se kundër tyre u përdorën armë zjarri dhe forcë e madhe fizike, edhe pse ata që në fillim bënë rezistencë të padhunshme”, thuhet në deklaratë.

Opozita dënon dhunën në veri, bën thirrje për shtensionim

Partitë opozitare në Kosovë kanë bërë thirrje për shtensionim të situatës në veri si dhe i kanë

dënuar sulmet ndaj pjesëtarëve të KFOR-it dhe gazetarëve.

Partia Demokratike të Kosovës (PDK), duke shprehur shqetësim për tensionet e krijuara, u ka kërkuar krerëve institucionalë në Kosovë që të “ndikojnë në qetësimin e situatës, rikthimin e normalitetit dhe evitimin e përshkallëzimit të mëtutjeshëm të gjendjes”. “Rikthimi i normalitetit është parakusht i fillimit të një qeverisjeje komunale të mirëfilltë, gjithëpërfshirëse dhe në shërbim të të gjithë qytetarëve të komunave në pjesën veriore të vendit”, tha PDK në një deklaratë të postuar në “Facebook”.

Kjo parti tha se “e kupton drejt seriozitetin e situatës dhe tensionin e ngritur në komunat e pjesës veriore të vendit” dhe e ftoi presidentin e Kosovës, Vjosa Osmani, edhe kryeministrin Albin Kurti, që “ta mbledhin urgjentisht Këshillin e Sigurisë së Kosovës”.

Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) thotë se veprimet e matura politike janë të domosdoshme për ta evituar çfarëdo përshkallëzimi të mëtutjeshëm të situatës në komunat në veri. “Koordinimi me miqtë tanë ndërkombëtarë është jetik. Institucionet e Kosovës duhet të sigurohen që asnjë veprim i mëtutjeshëm të mos bëhet pa koordinim të ngushtë me ta”, thuhet në reagimin e LDK-së.

Sulmet e dhunshme dhe të paprovokuara, sipas LDK-së, nuk kanë vend në shtetet demokratike dhe duhet të ndalen menjëherë. LDK thotë se institucionet e rendit dhe ligjit duhet t’i sjellin të gjithë kryerësit e sulmeve të tilla para drejtësisë.

Për situatën në veri ka reaguar edhe kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj. Përmes një postimi në “Facebook”, Haradinaj tha se “sulmet kriminale ndaj ushtarëve të KFOR-it dhe forcave të rendit janë të papranueshme dhe duhet të ndalen menjëherë”. Ai u bëri thirrje të gjitha palëve që t’i ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për qetësimin e situatës.

AGK-ja raporton për disa sulme ndaj gazetarëve në veri



AGK - Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës
Association of Journalists of Kosovo

PRISHTINË, 30 MAJ - Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës ka bërë me dije se gazetarët që po i përcjellin ngjarjet në veri kanë qenë cak i disa sulmeve. AGK-ja ka njoftuar se persona të maskuar kanë sulmuar gazetarë të medieve të ndryshme në Leposaviq dhe njërit medium i është thyer kamera. Po në këtë komunë gazetarët janë sulmuar edhe me gjësende të forta nga protestuesit serbë. “Në një transmetim direkt të medieve, shihen disa gra duke tentuar t’i pengojnë gazetaret e RTV Dukagjinit, Kohës dhe mediave të tjera të raportonin drejtpërdrejt nga kjo komunë”, ka njoftuar AGK-ja.

Ky asociacion bëri me dije se, përveç sulmeve ndaj gazetarëve, ka pasur sulme edhe ndaj makinave me të cilat udhëtojnë ekipet mediale në veri. Ekipit të televizionit Kanal 10 i është dëmtuar vetura në Zveçan, ndërsa vetura e ATV-së është vandalizuar, duke iu shpërthyer

gomat.

AGK tha se sulmet ndaj gazetarëve, të cilët po i përcjellin protestat e serbëve në veri, po shtohen. “Për AGK-në është e papranueshme gjendja e gazetarëve të cilët janë targeti i vazhdueshëm i protestuesve serbë. Teksa kjo rëndohet edhe më shumë, kur atyre nuk po u ofrohet mbrojtje e drejtpërdrejtë nga KFOR-i, dhe prezenca tjetër ndërkombëtare në atë pjesë të vendit”, u tha në njoftim.

Edhe të hënën ekipet mediale kanë qenë cak i tentimsulmeve dhe makinat e tyre janë vandalizuar teksa makina e një kanali televiziv është djegur. Serbët lokalë po protestojnë në veri të Kosovës për të dytën ditë me radhë, për t’i kundërshtuar kryetarët e rinj shqiptarë të Zveçanit, Leposaviqit dhe Zubin Potokut. Ata, gjithashtu, po kërkojnë tërheqjen e njësisve speciale të Policisë së Kosovës nga veriu.



Rama e Mujka nëshkruan memorandum për ujitjen e tokave bujqësore

PRISHTINË, 30 MAJ - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, së bashku me kryeshefin e "Ibër Lepencit", Faruk Mujka, kanë nëshkruar memorandumin e mirëkuptimit për

bashkëfinancimin e projektit "Ndërtimi dhe zgjerimi i kapaciteteve për ujitjen e tokave bujqësore". Qëllimi i kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi është ngritja e kapaciteteve të ujitjes, përkatësisht rivitalizimi i

disa pjesëve të sistemit të ujitjes. "Ky projekt krijon mundësi për rritjen e qëndrueshme të sektorit bujqësor, duke sjellë përfitime për komunitetin dhe ekonominë vendore", ka thënë kryetari Rama.



Në Podujevë mbahet debat publik për planin e veprimit për integrimin e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian

PODUJEVË, 30 MAJ - Në sallën e Kuvendit Komunal të Podujevës të martën është mbajtur debati publik për planin e veprimit për integrimin e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian 2023-2026. Pjesëmarrës në këtë debat publik ishin drejtori i Drejtorisë së Arsimit, Avni Fetahu, së bashku me udhëheqësin e Zyrës për Komunitete dhe Kthim, Liman Zeqiri. Në këtë dëgjim publik është diskutuar për gjendjen aktuale të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në komunën e Podujevës, në arsim, shëndetësi, vendbanim dhe punësim. Drejtori i DKA-së, Avni Fetahu, foli për gjendjen e përgjithshme dhe përfshirjen e komuniteteve pakicë në shkollim, në të dy nivelet, në atë fillor dhe në atë të mesëm.

Me theks të veçantë foli për mësimin shtesë, ku në bashkëpunim me organizata të ndryshme që merren me çështje të pakicave, kanë siguruar mësim shtesë për nxënësit që kanë ngecur në mësim. Ai i inkurajoi pjesëmarrësit dhe qytetarët të kontribuojnë me ide dhe projekte që ndihmojnë në integrimin e plotë të komuniteteve pakicë në secilën sferë të jetës shoqërore deri më 19 qershor në adresat adekuate për ta plotësuar këtë plan veprimi.

Ndërsa udhëheqësi i ZKK-së, Zeqiri, e cilësoi të mirë gjendjen e komuniteteve në komunën e Podujevës në përgjithësi, në veçanti në fushën e arsimit, ku tregoi se nga këto komunitete në të gjitha shkollat në Podujevë janë 195 nxënës dhe janë mirë të integruar në shkollim.



Kuvendi Komunal i Skenderajt miraton tri pika të rendit të ditës, njëra për ndërtimin e tregut të gjelbër



Skenderaj, 30 maj - Kuvendi Komunal i Skenderajt ka mbajtur të martën seancën e rregullt të cilën e ka udhëhequr kryesuesja Adelina Spahiu, në të cilën kanë marrë pjesë edhe kryetari Fadil Nura, drejtorët komunalë, anëtarët e Kuvendit, përfaqësues të OSBE-së dhe shoqërisë civile. Me këtë rast, asambleja ka pasur për shqyrtim tri pika të rendit të ditës, të cilat, pas diskutimit, janë miratuar. "Propozim-vendim për shpallje të interesit të përgjithshëm publik, pronë private, në funksion të realizimit të projektit të

ndërtimit të tregut të gjelbër në qytetin e Skenderajt; Propozim-vendim për miratim të Planit të Veprimit për Transparencë Komunale 2023-2027; Propozim-vendim për lejimin e mjeteve financiare nga Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, për mbështetje financiare të fermerit Misim Shabani. Pas diskutimeve në pikat e mësipërme dhe sqarimeve nga ana e kryetarit Nura dhe drejtorëve, Kuvendi ka miratuar të gjitha pikat e rendit të ditës", ka njoftuar komuna e Skenderajt.

Komuna e Prizrenit po bën restaurimin e objektit të vjetër ekzistues të shkollës "26 Marsi" në Landovicë

Prizren, 30 maj - Komuna e Prizrenit ka njoftuar se krahas investimeve për përmirësimin e infrastrukturës arsimore, po vazhdon ndërtimi i aneksit në objektin e

ShFMU "26 Marsi" në Landovicë, ku po bëhet restaurimi i objektit të vjetër ekzistues. Ky projekt, investim i Drejtorisë Komunale të Arsimit, përfshin katër

klasë mësimi, kabinet të lëndëve profesionale, ngrohjen qendrore me depo dhe nyjat sanitare për nxënësit (F/M) dhe personelin e shkollës. "Përmirësimi i kushteve në

shkolla dhe cilësia mësimore janë parakushte për të ardhmen e sigurt të të rinjve tanë dhe për zhvillimin ekonomik", ka njoftuar komuna e Prizrenit.



Nagavci i fton komunitat për shënimin e hapësirave për ndërtimin e çerdheve të reja

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 30 MAJ - "Edukimi në fëmijërinë e hershme është ndër prioritetet më të rëndësishme të qeverisë Kurti dhe në kuadër të përmbushjes së zotimit tonë, kemi hapur tenderin për ndërtimin edhe të katër çerdheve të tjera në Deçan, Viti, Milloshëvë - Obiliq dhe në Prizren", ka thënë ministrja e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Arbërie Nagavci, në konferencën për medie të martën, në të cilën ka folur për aktivitetet dhe të arriturat e fundit në arsim.

Nagavci ka theksuar se Ministria e Arsimit do ta vazhdojë realizimin e planit për ndërtimin e çerdheve e kopshteve të reja dhe i ka ftuar komunitat për bashkëpunim për shënimin e hapësirave për ndërtimin e çerdheve të reja. Ministrja Nagavci ka folur edhe për vendimin për ndarjen e 70 bursave në vlerë 500 euro për nxënës në Institucionet e Arsimit dhe Aftësimin Profesional në drejtimet deficitare dhe bursa për vajza në drejtime teknike. Po ashtu, ministrja Nagavci ka përmendur certifikimin e 15 këshilltarëve të parë të karrierës të nivelit të 5-të.

Ajo i ka ftuar komunitat t'i identifikojnë nevojat për këshilltarë të karrierës dhe t'i inkuadrojnë mësimdhënësit që kanë mungesë të orëve e të cilët shprehin vullnet për t'u rikualifikuar në këtë program. Ministrja Nagavci ka folur edhe për pakon ligjore për sistemin e licencimit të mësimdhënësve, e cila është paraqitur në fillim të këtij muaji, si dhe risitë që sjellin këto udhëzime, të cilat do të jenë në diskutim publik deri më 7 qershor 2023. Sa i përket raportit evropian për Kosovën, ministrja Nagavci ka thënë se ky raport ka evidentuar suksese dhe mesazhe pozitive për

Kosovën, përfshirë edhe në fushën e arsimit, ku është përshëndetur lansimi i Strategjisë së Arsimit 2022-2026, ndarja e bursave për studentët e fushave STEM, marrëveshjet e fundit në kuadër të Procesit të Berlinit për Njohjen e Kualifikimeve të Arsimit të Lartë dhe për Njohjen e Kualifikimeve Profesionale për mjekët, dentistët dhe arkitektët. Ministrja Nagavci, po ashtu, ka folur edhe për lansimin e programit të përbashkët me Ministrinë e Kulturës "Arti në shkollë", si dhe për ndërtimin dhe përuarimin e shkollës "Bajram Curri" në Krushë të Madhe të

Rahovecit në vlerë 1,471,538.31 euro. Ministrja ka theksuar edhe rëndësinë e bashkëpunimit me prindër në funksion të ngritjes së cilësisë në arsim dhe me këtë rast, i ka ftuar komunitat dhe shkollat t'i respektojnë të gjitha procedurat e parapara me UA. Në fund, ministrja ka folur edhe për thirrjet për projekte shkencore ku, ndër të tjera, përmendi se në thirrjen e fundit kemi pranuar gjithsej 25 aplikime, ndërsa vazhdon të jetë e hapur deri më 25 qershor 2023 thirrja për projekte të përbashkëta kërkimore tekniko-shkencore në mes të Shqipërisë dhe Kosovës.



Mehaj: Objektiva dyvjeçare e ushtrimit 'Defender Europe '23' për validimin e kapaciteteve të Regjimentit të Këmbësorisë është arritur

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 30 MAJ - Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka thënë se objektiva dyvjeçare e ushtrimit "Defender Europe '23" për validimin e kapaciteteve të Regjimentit të Këmbësorisë është arritur, ndërsa Forca e Sigurisë së Kosovës po vazhdon aktivitetin ditor në kuadër të bashkëpunimit me partnerët tanë strategjikë. Ministri Mehaj ka bërë me dije se rreth 1 300 ushtarë kanë treguar profesionalizëm të lartë në mesin e 25 shteteve pjesëmarrëse. "1 348 ushtarakët tanë kanë treguar profesionalizëm të lartë në mesin e 25 shteteve pjesëmarrëse të

këtij ushtrimi, gatishmëri për të shërbyer përkrah aleatëve tanë në çdo mision të NATO-s, me qëllim ruajtjen e paqes dhe stabilitetit në vend, rajon dhe më gjerë. Forca e Sigurisë së Kosovës, Forcë që garanton siguri për qytetarët dhe mbrojtje të territorit të Republikës së Kosovës", ka theksuar Mehaj. Kosova, si nikoqire e "Defender Europe 2023", është vendi i katërt me numrin më të madh të ushtarakëve në këtë stërvitje, midis 25 vendeve pjesëmarrëse. Mbi 1 300 ushtarë të Forcës së Sigurisë së Kosovës u bashkuan me 24 mijë ushtarë nga forcat e armatosura të vendeve të NATO-s dhe vendeve partnere të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Prezantimi statik i pajisjeve të FSK-së dëshmoi përgatitjen dhe profesionalizmin e forcave ushtarake të Kosovës. Kjo stërvitje paraqet një mundësi të rëndësishme për ta treguar angazhimin dhe përkushtimin e Kosovës në rrugën drejt anëtarësimit në NATO dhe në promovimin e paqes në rajonin e Ballkanit. Suksesi i "Defender Europe 23" në Kosovë, stërvitja më e madhja në rajon, i atribuohet mbështetjes së ministrit Mehaj dhe vizionit të tij për të ardhmen e FSK-së. Duke vënë në pah përkushtimin e Kosovës për ndërtimin e kapaciteteve ushtarake dhe anëtarësimin në NATO, si dhe gatishmërinë për ta mbrojtur vendin në çdo kohë.



10 mijë punëtorë të regjistruar në platformën "Super Puna"

PRISHTINË, 30 MAJ - Tashmë janë regjistruar 10 mijë punëtorë në "Super Puna". Sipas njoftimit për medie nga platforma "Super Puna",

kaq është edhe numri i atyre që janë të verifikuar në këtë platformë. "10 mijë punëkërkes të regjistruar dhe të verifikuar në Super

Puna", thuhet në njoftim. "Super Puna" është platformë punësimi e krijuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, e cila

do ta lehtësojë qasjen e të rinjve në tregun e punës dhe do t'i ndihmojë bizneset për angazhimin e punëtorëve të rinj.



Paga mesatare 521 euro në Kosovë, vetëm 37 euro rritje në vitin 2022



EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 30 MAJ - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar "Nivelin e Pagave në Kosovë" për vitin 2022. Ky publikim përmban të dhëna për pagën mesatare bruto dhe neto sipas sektorëve dhe aktiviteteve ekonomike në sektorin publik (administrata), ndërmarrjet publike dhe sektorin privat në Kosovë. Sipas ASK-së, në vitin 2022 pagat mesatare bruto në Kosovë ishin 521 euro, derisa

në vitin 2021 ishin 484 euro. Pra, kishte një rritje prej 37-eurosh nga viti paraprak. Kurse paga neto në vitin 2022 ishte 446 euro, krahasuar me vitin 2021 që ishte 432 euro. Pra, një rritje prej 14-eurosh. "Paga mesatare bruto në sektorin privat në vitin 2022 ishte 473 euro, derisa në vitin 2021 ishte 419 euro. Pra, kishte një rritje prej 54 eurosh. Ndërsa paga mesatare neto ishte 401 euro, krahasuar me vitin 2021 e cila ishte 376 euro. Pra, një rritje prej 25-eurosh", ka njoftuar ASK-ja.

Po në këtë publikim paga mesatare bruto në sektorin publik në vitin 2012 ishte 407 euro, derisa në vitin 2022 ishte 604 euro, duke u rritur për 197 euro, ose 48.4 për qind. Ndërsa paga mesatare neto nga 366 euro, sa ishte në vitin 2012, u rrit në 536 euro në vitin 2022. Një rritje prej 170 eurosh, ose 46.4 për qind. "Paga mesatare bruto në sektorin e ndërmarrjeve publike në vitin 2012 ishte 561 euro, derisa në vitin 2022 ishte 789 euro. Një rritje prej 228-eurosh ose 40.6 për qind.

Ndërsa paga mesatare neto nga 502 euro, sa ishte në vitin 2012, u rrit në 659 euro në vitin 2022. Një rritje prej 157-eurosh ose 31.3 për qind", theksohet në raportin e ASK-së.

Niveli i pagave më të larta në Kosovë ishte sektori i ndërmarrjeve publike, derisa me paga më të ulëta ishte sektori privat. "Paga mesatare bruto në vitin 2022, sipas aktiviteteve ekonomike, më a larta ishte te: furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar (968

euro) dhe informimi dhe komunikimi (896 euro). Derisa paga më e ulët ishte tek akomodimi dhe aktivitetet e shërbimeve me ushqim (323 euro). Paga mesatare neto në vitin 2022, sipas aktiviteteve ekonomike, ka të njëjtën renditje si më poshtë: Furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar (804 euro); informim dhe komunikim (745 euro); akomodimi dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim (277 euro)", ka njoftuar ASK-ja.

Lira turke shënon rënie të madhe pas fitores së presidentit Erdogan

STAMBOLLIT, 30 MAJ - Presidenti amerikan Joe Biden zhvilloi një bisedë telefonike me homologun turk Rexhep Taip Erdogan për ta uruar për fitoren në balotazhin e së dielës në Turqi. Erdogani siguroi edhe një mandat pesëvjeçar duke fituar ndaj kandidatit të opozitës së bashkuar, Kemal Kılıçdaroglu.

Presidenti Erdogan duhet të përballlet me inflacionin në rritje që ka nxitur një krizë të kostos së jetesës. Kundërshtari i tij kishte kërkuar të ndryshonte prirjet gjithnjë e më autoritare të Erdoganit, duke premtuar se do t'u kthehej normave demokratike. Por, në fund,

votuesit zgjodhën njeriun që ata e shohin si një udhëheqës të fortë.

Pasi rezultatet i dhanë atij 52 për qind të votave në balotazhin e së dielës, krahasuar me 48 për qind për rivalin e tij, Kemal Kılıçdaroglu, Erdogani mbajti dy fjalime falënderuese, një në Stamboll dhe një në Ankara "Askush nuk ka humbur sot. Të 85 milionë turqit fituan. Si kërkesë e përgjegjësive që na ka dhënë kombi ynë, ne nuk jemi të ofenduar, të inatosur apo të zemëruar me askënd. Tani është koha t'i lëmë mënjanë të gjitha debatet dhe konfliktet e fushatës zgjedhore dhe të



bashkohemi rreth synimeve dhe ëndrrave tona kombëtare",

ka theksuar presidenti turk Erdogan.

Pas konfirmimit të fitores së Erdoganit, lira turke shënoi rënie rekord ndaj dollarit amerikan të hënën, mirëpo bursa turke tregoi shifra në rritje. Lira turke ka rënë rreth 7 për qind që nga fillimi i vitit dhe ka humbur më shumë se 90 për qind të vlerës së saj gjatë dekadës së fundit.

Banorët e Stambollit, megjithatë, shprehën optimizëm. "Unë mendoj se kursi i këmbimit do të rritet më tej nga ky moment. Nuk mund të them një numër të saktë, por mendoj se do të jetë shumë më i lartë se shifra aktuale deri në fund të vitit", thotë banori i Stambollit, Omer Yıldız.

“Ishte 14 vjeç, e keqtrajtuar, e kërcënuar dhe nuk tregoi vendndodhjen e ushtarëve të UÇK-së”, ngjarja e panjohur e dëshmorit Liridon Dërmaku

Nga: Drita DËRMAKU

Liridon Dërmaku nuk arriti të diplomohet për farmaci për shkak të dashurisë ndaj atdheut dhe mbrojtjes së tokave nga armiku. Ai u vra në natën e 24 dhjetorit të vitit 2004 në Tetovë, aty ku studioje në Fakultetin e Mjekësisë. Ëndrra e tij për t'i shërbyer vendit, në fushën e mjekësisë apo në ushtri, përfundoi atë natë ku u rrethua nga pala sllavo-maqedonase. “Gjatë studimeve u dallua si student dhe ishte shumë i vendosur për zgjidhjen e problemeve që i dilnin përpara. Kishte karakter të fortë dhe ishte shumë i afërt me kolegë”. Këto ishin disa nga vlerësimet që janë cekur në librin “Dërmaku” me autorë: Ismet Dërmaku, Sulejman Dërmaku dhe Hasim Dërmaku.

Vëllai i Liridonit, Faton Dërmaku, përshkruan ngjarjen se çfarë ndodhi deri te vrasja e të vëllait. “Para se të vritej Liridoni, disa ditë më parë, pala maqedonase dhe ajo e UÇK-së pajtohen për paqe. U arrit ajo lloj marrëveshje që të mos përndiqeshin me ish-ushtarët e UÇK-së dhe që të tërhiqeshin këta të fundit nga disa vende të kontrolluar prej tyre. Armatimin që kishin e dërgojnë në banesën



e Liridonit. Pala sllavo-maqedonase e thyen marrëveshjen dhe pabesisht sulmohet grupi i Liridonit, mbetet i vrarë Liridoni, disa të

tjerë të plagosur dhe disa të vrarë nga pala maqedonase”.

Në atë kohë të kontribuojë për atdhe, për të drejtat e shqiptarëve dhe jashtë Kosovës, nuk ka qenë e lehtë. Liridoni, pasi pa gjendjen e vështirë të shqiptarëve në Maqedoni, filloi kontributin me pjesëtarët e UÇK-së që atëkohë vepronin në Maqedoni.

Fatoni u shpreh se atë natë kur u sulmua Liridoni me shokët, burimet brenda spitalit të Tetovës thoshin se tre policë sllavo-maqedonas kanë qenë pa shenja jete dhe një i plagosur rëndë është transferuar për në Spitalin e Shkupit, ndërsa Liridoni për shkak të plagëve nuk ka mundur të mbijetojë. “Disa pjesëtarë të tjerë të UÇK-së kanë qenë të plagosur rëndë dhe disa të tjerë që ishin shokë të Liridonit ishin arrestuar nga maqedonasit e disa të tjerë kanë arritur të mos bien në duart e sllavo-maqedonasve”, shtoi tutje Fatoni.

Nga fëmijëria deri në studime

Liridon Dërmaku lindi më 17 korrik 1983 në Gjilan, nga babai Sejdiu dhe nëna Feridja. Shkollën fillore e kreu në fshatin Shipashnicë të komunës së Kamenicës. Shkollimin e mesëm e vazhdoi për mjekësi në Gjilan në Shkollën e Mesme “Asllan Elezi” dhe e mbaroi me sukses në vitin 2002.

Sipas librit “Dërmaku”, Liridoni ishte djalë shumë inteligjent dhe i përkushtuar në shkollim,

bashkëpunues në çdo aspekt dhe me çdo njeri.

Në librin “Dërmaku” thuhet se frymëzimi i tij për të kontribuar për atdhe vinte nga babai dhe xhaxhallarët. Babai i tij Sejdi Dërmaku kontribuoi për vendin që nga moshën 16 vjeçe. Me fillimin e luftës e tërë familja i shërbente popullit duke strehuar dhe duke përcjell ushtarë. Në furnizimin e luftëtarëve me ushqim, veshmbathje e municion i ndihmonte Liridoni që atë kohë ishte vetëm 14 vjeç.

“Në maj të vitit 1999 policia dhe ushtria serbe, pasi plaçkitin shtëpitë, e marrin Liridonin, e keqtrajtojnë dhe madje e kërcënojnë me vrasje, po ai nuk u tregoi se ku ishin luftëtarët e UÇK-së”, thuhet tutje në librin “Dërmaku”.

Florentin Kryeziu tregoi se me Liridonin janë njohur në studime dhe ishin në të njëjtin drejtim. “Për herë të parë u takuam në vitin 2002-2003, dhe

Përkujtimet për Liridon Dërmakun

Kryesia Qendrore e Frontit për Bashkimin Kombëtar Shqiptar, me vendimin nr. 16/4, me datë 26 mars 2005, Liridonin e shpall “Dëshmor të Kombit Shqiptar”.

Më 22 dhjetor të vitit 2008 u organizua academia përkujtimore me rastin e katërvjetorit të rënies heroike të dëshmorit të kombit Liridon Dërmaku e cila u mbajt në Sallën e Kuqe të Universitetit të Prishtinës në Prishtinë. Në atë organizim flitet për kontributin e të ndjerit.

Aty thuhej se Liridoni lexonte shumë dhe frymëzohej nga vjershat patriotike.

“Në mendjen e tij silleshin vargjet e poetit Ismail Kadare, i cili shkruan:

Dhe dije ti grua
Ti djalë, e ti, plak
Se pragu i shtëpisë
Nuk është ky prag
Po pragu i shtëpisë




duke qenë një shok i mirë, filluam të ndanim kohë më shumë dhe e bëri më të fortë shoqërinë tonë edhe drejtimi i njëjtë i Farmacisë”, tha Kryeziu. Rreth vrasjes së Liridonit, Kryeziu tregon se ku ishte atë natë kur ndodhi rrethimi. “Në periudhën në të cilën ka ndodhur rasti unë nuk isha aty, kam qenë në shtëpi për arsye të pasaportës, për vazhdim të afatit. Lajmin për Liridonin e kam marrë vesh nga mediet”, tha ai.

Është larg, shumë larg
Kufiri i Vatanit,
Ai është prag.”

Faton Dërmaku e përkujton vëllanë si njeri punëtor, i dhënë pas familjes dhe shkollimit. Florentin Kryeziu e kujton shokun kështu: “Ishte i dashur për rrethin të cilin e kishte, e çmonte familjen”. Për nder të dëshmorit Liridon Dërmaku atij ia ngritën bustin në vitin 2008, në vendlindjen e tij, në Shipashnicë të Epërme.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Të dielën zhvillohet ndeshja e barazhit në mes të Lirisë dhe Ferizajt

PRISHTINË, 30 MAJ - Edicioni 2022/23 i Superligës së Kosovës në futboll përfundon të dielën kur do të zhvillohet ndeshja e barazhit. Në këtë ndeshje do të mësohet skuadra e dhjetë, e cila do të bëjë gara në elitë në edicionin e ri. Nga Liga e Parë, Liria ishte

në vendin e dytë dhe fitoi përballjen ndaj Ulpianës me rezultat 3-1 për të shkuar në finalen e barazhit. Ndërsa nga Superliga, Ferizaj përfundoi në vendin e tetë dhe tash do të përballet me skuadrën e Lirisë. Prizrenasit synojnë rikthimin në elitë pas katër viteve të

kaluara në Ligën e Parë. Në anën tjetër, Ferizaj është një nga skuadrat më të organizuara në Kosovë dhe kërkon ta ruajë statusin e skuadrës elitare. Kjo përballje zhvillohet të dielën me fillim nga ora 15:00 në stadiumin "Zahir Pajaziti" në Podujevë.



KOK-u ankohet në Komitetin Olimpik Ndërkombëtar për mesazhin e provokatorit Gjokoviq

PRISHTINË, 30 MAJ - Komiteti Olimpik i Kosovës (KOK) ka dërguar sot ankesë në Komitetin Olimpik Ndërkombëtar në lidhje me mesazhin provokues dhe politik të tenistit serb Novak Gjokoviq. Gjokoviq vazhdoi dhe dje provokimet e tij politike, duke shkruar mesazhe me propagandë pro-serbe: "Kosova është zemra e Serbisë, ndaleni dhunën". Me këtë rast, KOK-u ka kërkuar nga Komiteti Olimpik Ndërkombëtar (KON/IOC) të marrë masa ndaj Gjokoviqit për mesazhet politike në dëm të një vendi të pavarur dhe anëtar i IOC-ut siç është Kosova. "Gjokoviqi promovoi sërish propagandën e nacionalistëve serbë dhe përdori platformën sportive për ta bërë këtë. Po ashtu, deklaratat e mëtejshme të bëra nga një personazh i tillë

publik, pa asnjë ndjenjë pendimi, rezultojnë drejtpërdrejt në ngritjen e nivelit të tensionit dhe dhunës mes dy vendeve, Kosovës dhe Serbisë", thuhet në fillim të reagimit. KOK-u një kopje të reagimit ia ka dërguar edhe Federatës Ndërkombëtare të Tenisit. "Si presidenti i KOK-ut e ndiej për obligim t'i ngreh shqetësimet e mia dhe ju kërkoj të reagoni në emër të Komitetit Olimpik Ndërkombëtar, pasi këto mesazhe dhe veprime janë të rrezikshme për të ardhmen e sportit, nëse mbesin pa u ndëshkuar. Sipas Kartës Olimpikë (parimi themelor 5), siç u përmend më lart, organizatat sportive në kuadër të lëvizjes olimpikë do ta zbatojnë neutralitetin politik dhe duke pasur parasysh se ITF është



Federatë Ndërkombëtare e njohur nga IOC, unë me respekt kërkoj që IOC të reagojë në kuadër të saj dhe t'i kërkojë ITF-së ta hetojë çështjen duke hapur procedurë disiplinore kundër sportistit", thuhet më tej në

reagimin e dërguar nga presidenti Krasniqi për presidentin e IOC-ut, Thomas Bach. "I nderuari president, ajo që ndodhi në 'French Open' perceptohet si shkelje e parimeve sportive dhe shpirtit

olimpik, si një shkelje e Kartës Olimpikë. Pavarësisht se Gjokoviqi është një nga tenistët më të mirë, një sjellje e tillë e përsëritur nuk mund të tolerohet, pasi krijon një precedent të rrezikshëm që sporti mund të përdoret si një platformë për mesazhe politike, agjenda dhe propagandë. Unë me të vërtetë shpresoj që IOC të ngrehë zërin në emër të sportit dhe të tregoj edhe një herë, siç e keni treguar gjithmonë, se sporti nuk mund të përdoret për mesazhe dhe agjenda politike dhe ju falënderoj paraprakisht për vëmendjen që do të rezervoni për këtë çështje", shkruan në fund të reagimit të të parit të KOK-ut. Mesazhi i Gjokoviqit nuk ishte i tilla politike në ngjarje të ndryshme të tenisit.

Krasniqi: Nëse vërtetohet që ka kurdisje, FFK-ja duhet t'i marrë masat e duhura

Prishtinë, 30 maj - Xhiroja e fundit e Superligës së Kosovës në futboll ngjalli reagime të shumta nga opinioni sportdashës në Kosovë për shkak të dyshimeve se mund të jenë kurdisur ndeshjet Trepça '89 - Prishtina dhe Ferizaj - Dukagjini. Në këtë të fundit, portieri i Dukagjinit pranoi një gol që po konsiderohet si pranim i qëllimshëm duke ia dhënë fitoren Ferizajt që rrjedhimisht solli edhe sigurimin e barazhit të kësaj skuadre për mbetje në Superligën e Kosovës, ndërsa nga ana tjetër e pësoi



Trepça '89 që ra në Ligën e Parë. Në lidhje me këto dyshime ka reaguar edhe Komiteti Olimpik i Kosovës. Presidenti i shtëpisë më të madhe të sportit në Kosovë, Ismet Krasniqi, ka thënë për "KosovaPress" se janë fuqishëm kundër këtyre dukurive negative që e dëmtojnë imazhin ndërkombëtar të sportit të Kosovës, në këtë rast të futbollit. Ai ka shtuar se beson tek organet kompetente brenda Federatës së Futbollit të Kosovës se do t'i marrë masat e duhura nëse dyshimet e tilla konfirmohen.

"KOK-u është fuqishëm kundër dukurive të tilla negative që dëmtojnë imazhin e mirë që sporti dhe në këtë rast futbollit kanë krijuar në arenën ndërkombëtare. Ne besojmë fuqishëm tek organet kompetente të FFK-së, që t'i marrin masat e duhura në rast se vërtetohet që ka pasur dukuri të tilla", ka thënë Krasniqi. Ndërkohë, Këshilli për Sport dhe Ministria e Sportit tashmë kanë konfirmuar se kanë kërkuar nga prokuroria t'i nisë hetimet për këto dy ndeshje.

Krasniqi: Më 5 gusht do të shkruajmë histori

PRISHTINË, 30 MAJ - Haxhi "Robin" Krasniqi synon ta jetojë ëndrrën e kamotshme për të boksuar dhe për të fituar në vendin ku i rrah zemra, Kosovë. Boksieri i suksesshëm bëri karrierë të jashtëzakonshme jashtë vendit, ndërsa më 5

gusht do ta plotësojë ëndrrën e tij dhe të krejt fansave për të boksuar në Kosovë. Meçi i radhës i tij do të zhvillohet në stadiumin "Fadil Vokrri". Ish-kampioni i botës në boksion profesionist në "Facebook" ka paralajmëruar se do të

shkruhet historia me atë datë. "Me 5 gusht do të shkruajmë histori!", ka shkruar 36-vjeçari nga Juniku. Pasi data dhe vendi i meçit të ardhshëm tashmë dihen, ka mbetur për t'u caktuar vetëm edhe kundërshtari i Krasniqit.



Fury i kërkon sërish luftë Joshuas

Wythenshawe, 30 maj - Tyson Fury ka pohuar se ka bërë një përpjekje të re për të organizuar një luftë me Anthony Joshuan. Kampioni i peshave të rënda të WBC nuk ka luftuar që nga humbja nga Dereck Chisora në dhjetor si pasojë e dështimit për

të rënë dakord për kushtet për një përballje me mbajtësin Oleksandr Usyk. Dihet se ka ambicie që kjo përballje të zhvillohet në dhjetor në Arabinë Saudite, së bashku me një përballje midis Deontay Wilder dhe Joshuas. Nëse kjo ngjarje do

të realizohet, mbetet për t'u parë. Ndërsa Eddie Hearn, promotor i Joshuas, ka deklaruar shpesh se Joshua dëshiron të luftojë në gusht kundër Wilderit. Të premtën në mbremje Fury doli në medie sociale për të thënë se donte të ndeshet me Joshuan në

“Wembley” në shtator, komente këto që erdhën në të njëjtën javë ku ai tregoi se dalja e tij e radhës mund të ishte në Australi kundër Demsey McKean. Në javët pasi Joshua humbi revanshin e tij me Usyk, Fury përdori platformën për t'u përpjekur të pajtohej me



atë që mund të ishte përballja më e madhe britanike në histori.

Xavi: Nuk ka asnjë dyshim se Messi do të na ndihmonte

BARCELONË, 30 MAJ - Dy vjet më vonë Lionel Messi do të jetë edhe një herë historia e madhe e verës dhe Barcelona shpreson se do të ketë një fund më të lumtur për ta këtë herë. Xavi e bëri të qartë se Messi do të ishte më se i mirëpritur të kthehej në “Camp Nou”. Ka pasur sugjerime që Messi nuk do t'i përshtatej më stilit aktual të lojës së Barcelonës dhe se ai mund të mos ishte në të vërtetë një nënshkrim ideal për Xavin pavarësisht statusit të tij në klub dhe në mbarë botën. Megjithatë, trajneri katalanas duket i etur për t'i zvogëluar këto shqetësime pasi Barcelona përpjet ta krijojë terrenin për një përpjekje për ta rinëshkruar Messin këtë verë.

“Për momentin nuk ka dyshim se Messi do të na ndihmonte. Leo mund të luajë në pozicione të ndryshme: nëntë fals, sulmues anësor, mesfushor, apo edhe si numër 10. Ai është bërë pothuajse një mesfushor qendror, pothuajse një mesfushor sulmues dhe ai e ka atë aftësi në fund të ditës”, ka thënë Xavi për “Sport”. Messi së shpejti do të jetë 36-vjeçar dhe disa besojnë se ai ka humbur një pjesë të eksplozivitetit që dikur e përdorte aq mirë. Megjithatë,



Xavi vuri në dukje Kupën e Botës, për të ilustruar se kapiteni i Argentinës mund të jetë ende një krijues i ndryshimit në nivelin më të lartë. “Në Kupën e Botës ne e pamë Messin në një nivel të pabesueshëm. Mendoj se i kanë mbetur edhe shumë vjet në një nivel të mirë”. Xavi, gjithashtu, zvogëloi sugjerimet se Messi nuk do të përshtatej taktikisht në skemën e tij ose se atij i mungojnë kërkesat mbrojtëse, duke treguar se si lojtarët e tjerë janë përshtatur ose kanë prishmëri të ndryshme. Megjithatë, biseda kryesore është ajo nëse një operacion për ta sjellë Messin në Barcelonë është i zbatueshëm. Xavi pranoi se ka

folur me presidentin Joan Laporta për ish-nr. 10 të Barcelonës dhe ka komunikuar interesimin e tij për ta pasur atë në ekipin e tij. “Për mua ka kuptim. Nuk ka dyshim se nëse Messi kthehet, kjo do të ndihmonte në kuptimin futbollistik. Unë ia kam thënë presidentit këtë. Nuk kam asnjë dyshim... sepse ai është ende një lojtar që mund të bëjë diferencën, ai është ende i uritur, ai është një fitues, një lider dhe ai është një lojtar tjetër. Ne nuk kemi një skuadër të Barcelonës me talentin e vitit 2010... Messi do ta sillte talentin, topin e fundit, grupin, golat...”, ka përfunduar trajneri i Barcelonës.

Miami kualifikohet në finalen e madhe të NBA-s

Boston, 30 maj - Miami Heat ka fituar më në fund ndeshjen e katërt ndaj Boston Celticsit për t'u shpallur kampion në Konferencën e Lindjes dhe për të shkuar në finalen e madhe të NBA-s. Heat ishte në epërsi 3-0, ndërsa Celticsi barazoi në 3-3 për t'u vendosur gjithçka në ndeshjen e shtatë në TD Garden të Bostonit. Megjithatë Heat ka qenë më i mirë dhe ka triumfuar në ndeshjen e shtatë me 19 pikë diferencë 84:103 për të kaluar këtë seri dhe për të shkuar në finalen e madhe. Më meritori për fitoren e Heat ishte Jimmy Butler që realizoi 28 pikë, pasi shtatë kërcime e gjashtë asistime. Me lojë të mirë të skuadra fituese u dallua edhe Martin me 26 pikë e



10 kërcime si dhe Bam Adebayo që realizoi 12 të tjera. Te vendasit më efikas ishte Jaylen Brown me 19 pikë, por që nuk mjaftuan për fitore. Jimmy Butler u shpall MVP i Konferencës së Lindjes

pasi ka shkëlqyer në të gjitha ndeshjet. E në finalen e madhe të NBA-s, Heat do të përballlet me Denver Nuggetsin që u shpall kampion në Konferencën e Perëndimit.

Brazili e kërkon me ngulm Ancelottin

Presidenti i Federatës së Futbollit të Brazilit, Ednaldo Rodrigues, ka thënë se trajneri Carlo Ancelotti mbetet plani “A” i tyre për ta

drejtuar përfaqësuesen braziliane. Ai është optimist se Ancelotti do ta pranojë ofertën për ta drejtuar Brazilin. “Ai e do

ekipin përfaqësues të Brazilit. Ai njih shumë lojtarë të Brazilit dhe futbollin brazilian”, ka thënë Ridrigues për “OUL Esporte”.

Ancelotti aktualisht është trajneri i Real Madridit, kurse Brazili ende nuk ka vendosur se kush do jetë pasuesi i Tites, i cili u

largua pas dështimit në Kupën e Botës në Katar. Tite drejtoi Kombëtaren e Brazilit që prej vitit 2016.

SHKURT

Loriana Kuka dhe Akil Gjakova përfaqësojnë Kosovën në Takhikistan

Kosova do të përfaqësohet me Loriana Kukën dhe Akil Gjakovën në garën Grand Prix që do të zhvillohet në kryeqytetin e Takhikistanit, Dushanbe. 42 shtete e kanë konfirmuar pjesëmarrjen e në total do të garojnë 313 atletë. Përballjet për medalje fillojnë nga dita e premte, më 2 qershor, e vazhdojnë të shtunë dhe të dielën. Loriana Kuka garon në 70 kg, kurse Akil Gjakova në 73 kg.

Ofertë e ‘çmendur’ nga Bayerni për Ricen

Bayern Muncheni është shpallur me shumë fat kampion në Gjermani, por në këtë klub po bëhen reforma të mëdha. Përveç që ka ndryshime në stafin drejtues, ndryshime pritet të ketë edhe në radhët e futbollistëve, derisa në klub e kanë përpiluar edhe listën e përforcimeve. “Daily Express” raporton se Bayerni e ka përgatitur një superofertë për mesfushorin e West Ham Unitedit, Declan Rice. Gjithnjë sipas këtij mediumi, “bavarezët” janë gati të shpenzojnë 95 milionë sterlina për mesfushorin e përfaqësueses angleze, i cili kërkohet edhe nga Arsenali.

Napoli nis bisedimet me Enriqen

Luciano Spalletti është larguar nga Napoli pasi e shpalli kampion në Serinë A. Skuadra italiane ka nisur bisedimet me trajnerin Luis Enrique për ta emëruar në krye të ekipit para fillimit të sezonit të ri, shkruajnë mediet italiane. Enrique, krahas Napolit, ka oferta edhe nga ekipet e tjera, derisa më parë ishte në negociata edhe me Chelsea.

Navas: Mezi e pres finalen ndaj Romës

Sevilla përballlet me Romën në finalen e Ligës së Evropës e cila zhvillohet të mërkurën nga ora 21:00. Futbollisti me shumë përvojë i Sevilas, Jesus Navas, në një intervistë për “UEFA.com” ka folur për këtë finale, duke thënë se mezi e pret përballjen me Romën që është kundërshtar e vështirë. “Mezi pres, pasi është një tjetër mundësi e madhe. Ne do të përballlemi me një kundërshtar shumë të vështirë dhe do të jetë një ndeshje e vështirë. Shpresoj ta fitojmë finalen. Liga e Evropës është një kompeticion që na ka dhënë shumë dhe kënaqësia që ndiejmë ndeshje pas ndeshjeje na shtyn të shkojmë sa më larg”, ka thënë Navas.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Avokate Teuta Gashi” SH.P.K. me seli në Gjilan, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811923334 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Avokate Teuta Gashi” D.O.O. od Gnjilane, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811923334 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Avokate Teuta Gashi” L.L.C. with headquarters Gjilan, has come to the decision to quit its business: 811923334 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Dison Palushi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10,11,12 të sh.m.t “Nexhmedin Nixha” Gjakovë.

- Jozefina Gjiododa shpall të pavlefshme dëftesën e plotë shfmu “Dëshmorët Lleshi” Doblbare KK Gjakovë.

- Bardha Stublla nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. III të Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Diellza Mulla Hasani nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Universitetit “Fehmi Agani” Gjakovë me nr. 377 programi Infermieri.

- Skin Sers “SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330478588.

- Besart Myftari B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb 811937046.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA HALAL FOOD PASHTETË PULE

gluten
free



100% mish pule



cilësi e garantuar

pa konservues